



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 294212019

Nr./Iq/Bi.str./Nr./pg.
Data/Datum/Date: 16/12/19

PRISHTINE-PRIŠTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

LETËR REKOMANDIMI

përkitazi me

vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë të Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës

Për: Z. Abelard Tahiri, Ministër
Ministria e Drejtësisë

Z. Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Drejtësisë

Z. Uran Ismaili, Ministër
Ministria e Shëndetësisë

Z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Shëndetësisë

Z. Milazim Gjocaj,
Drejtor i Departamentit të Shëndetësisë në Burgje

Z. Nehat Thaçi, Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Jeton Mehmetaj, Drejtor
Qendra e Paraburgimit në Pejë

Prishtinë, 16 dhjetor 2019

Qëllimi i vizitës

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejmhë: MKPT) i Avokatit të Popullit, më 13 nëntor 2019, e ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Pejë (në tekstin e mëtejmhë: QPP). Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së të dërguara përmes raportit me rekomandime të datës 22 nëntor 2018.¹

Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës së MKPT-së në QPP, personeli i Shërbimit Korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e QPP-së. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues.

Keqtrajtimi fizik

MKPT-ja, gjatë vizitës në QPP, ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve dhe të të dënuarve dhe nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Po ashtu nuk ka marrë asnjë ankesë lidhur me sjelljet e zyrtarëve korrektues, të cilat do të përbënë trajtim që nuk është në pajtim me respektimin e dinjitetit njerëzor të të burgosurve. Gjatë vizitës është vërejtur komunikim interaktiv dhe miqësor ndërmjet personelit korrektues dhe të burgosurve.

Kushtet e akomodimit

MKPT-ja, gjatë vizitës, ka marrë ankesa nga të paraburgosurit dhe nga të dënuarit, lidhur me kushtet e akomodimit, të cilat, në kuptim të hapësirës për të burgosurit, ndriçimit natyral dhe artificial, nuk janë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP) e as me standarde Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT). MKPT-ja u njoftua nga drejtori se gjatë këtij viti QPP-ja është gëlqerosur.

Kujdesi shëndetësor

Gjatë vizitës, MKPT-ja nuk ka marrë ankesa të besueshme lidhur me kujdesin e ofruar shëndetësor nga njësia shëndetësore në QPP. Shërbimet shëndetësore të cilat nuk mund të ofrohen në QPP, ofrohen në institucionet e tjera publike shëndetësore. Megjithatë, njësia shëndetësore, për shkak të infrastrukturës, vepron në kushte shumë të vështira.

Regjimi

MKPT-ja ka vërejtur se për shkak të infrastrukturës, pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë së QPP-së, QPP-ja nuk ka mundësi që të ofrojë angazhim në punë, as në aktivitete të mirëfillta për risocializim, e as ndonjë trajnim eventual për të burgosurit. MKPT-ja u njoftua se 8 të burgosur janë të angazhuar në punë. Në dispozicion të të burgosurve mbeten daljet në ajër të pastër dy herë në ditë nga një orë dhe një tavolinë ping-pongu e vendosur në oborr të QPP-së dhe shikimi i TV-së në qelitë e tyre.

¹ MKPT, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, publikuar më 22 nëntor 2018. Për më shumë shih: <https://www.oik-rks.org/2018/11/22/raport-me-rekomandime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>

Angazhimi në punë, në aktivitete apo në trajnime, në përgjithësi, mbetet sfidë edhe për QPP-në, për shkak të infrastrukturës dhe faktit që angazhimi i të paraburgosurve në punë apo në aktivitetet të tjera shpesh është subjekt i lejes nga gjykata kompetente. Megjithatë, MKPT-ja inkurajon autoritetet kompetente që të përpilen që të ofrojnë për të paraburgosurit një regjim më të pasur me punë, me trajnime dhe me aktivitete të tjera, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se, sa i përket angazhimit të të paraburgosurve në punë, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: “*I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtoren e institucionit.*”

Ndërsa neni 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: “*I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrethin e institucionit korrektaës pas marrjes së pëlgimit të gjykatës kompetente.*”

Po ashtu, Rregullat e Mandelës përcaktojnë të drejtën e të paraburgosurit për të punuar. Në Rregullin 116 të Rregullave të Mandelës shprehimisht theksohet: “*Të paraburgosurit duhet ti ofrohet mundësia të punojë, por nuk duhet ti kërkohet të punojë. Nëse ai/ajo përcaktohet që të punojë, ai/ajo duhet të paguhet.*”

Në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili ishte publikuar në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjinin për të paraburgosurit, kishte shprehur shqetësimin që, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, përvëç dy orëve të shëtitjes në ditë, duke shikuar TV dhe duke luajtur me letra.

Përmes këtij raporti, KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente në Republikën e Kosovës, si në vijim: “*KPT, ri-përsërit rekomandimin që autoritetet të angazhohen që të rrisin aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në të gjitha institucionet të cilat KPT i vizitoi, dhe në të gjitha institucionet tjera të Shërbimit Korrektaës të Kosovës ku një gjë e tillë është e përshtatshme.*”

Më tej KPT-ja thekson: “*Sa më e gjatë që është periudha e paraburgimit, aq më shumë duhet të zhvillohet regjimi i cili u ofrohet atyre. Po ashtu, duhet të ndërmerrin veprime që edhe numri i personelit, ku një gjë e tillë është e nevojshme, të rritet.*”

MKPT-ja konsideron se, bazuar në legjpcionin në fuqi, në Rregullat e Mandelës dhe në rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, jo vetëm në QPP, por edhe në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

Kontaktet me botën e jashtme

Kontaktet me botën e jashtme mbeten në nivel të kënaqshëm. Në dispozicion të të dënuarve dhe të të paraburgosurve janë vizitat familjare dhe telefonatat, si dhe vikendet për të dënuarit të cilat i plotësojnë kriteret.

Rekomandimet e MKPT-së të dërguara përmes raportit të publikuar më 22 nëntor 2018

- 1. Ministria e Drejtësisë ta njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me pretendimet e punonjësve të QPP-së se kjo qendër do të mbyllt.** MKPT-ja nuk mori përgjigje nga Ministria e Drejtësisë lidhur me këtë rekomandim. Megjithatë, gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga drejtori i QPP-së se lidhur me këtë nuk ka vendim zyrtar nga Ministria e Drejtësisë lidhur me çështjen e mbylljes së QPP-së.
- 2. Të krijohen kushte dhe hapësirë adekuate të punës për personelin mjekësor.** Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se nuk pati asnjë ndryshim dhe personeli mjekësor vazhdon t'i kryejë detyrat në kushte të vështira dhe me mungesë hapësire.
- 3. Numri i të paraburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP-së dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejt që të jetë e mundur.** MKPT-ja gjatë vizitës nuk ka vërejtur raste të mbipopullimit e as të tejkalimit të kapacitetit zyrtar të QPP-së.
- 4. Kushtet e akomodimit, përderisa kjo qendër është në përdorim, të janë në pajtim me standardet minimale të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.**

MKPT-ja, gjatë vizitës, ka vërejtur se kushtet e akomodimit në QPP nuk janë në pajtim me LESP-në e as me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve sa i përket hapësirës, ndriçimit natyral dhe artificial. Në qeli të caktuara (krahu B), MKPT-ja ka vërejtur se ka depërtuar lagështia. Edhe përmes raportit me rekomandime të publikuar më 22 nëntor 2018, MKPT-ja konstatoi të njëjtën gjendje.

QPP-ja u vizitua dy herë nga KPT-ja (në vitin 2007 dhe në vitin 2015). Sa i përket kushteve të akomodimit, KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2007, këto kushte i përshkruan si shumë të këqija dhe konstaton se madhësia e qelive nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara nga ky komitet. Përveç kësaj, në raport thuhet se qelitë nuk kanë ventilim dhe ndriçim të duhur.

Po ashtu, KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, konstatoi se nuk ishin përmirësuar kushtet e akomodimit dhe përgjithësisht mbeten ashtu siç u konstatua edhe në raportin për vizitën në vitin 2007.

Më tej KPT-ja, në raportin e saj, konstaton: “*Për sa kohë që kjo qendër është në përdorim, duhet bërë përpjekje për të siguruar që anekset sanitare të mbahen në gjendje të pranueshme sa i përket kushteve fizike dhe që të burgosurve t'u sigurohen 4m2 hapësirë për person në qelitë ku akomodohen më shumë se një i paraburgosur.*”

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon

Ministrisë së Drejtësisë:

- MKPT-ja ripërsërit që të krijohen kushte dhe hapësirë adekuate të punës për personelin mjekësor.**
- MKTP-ja ripërsërit rekomandimin që kushtet e akomodimit, përderisa kjo qendër është në përdorim, të janë në pajtim me standardet minimale të**

përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; me standartet e KPT-së dhe me standartet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

- Të bëhen përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit